



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME TEKNOLOGJIKE "HYSEN ÇELA" DURRËS

Nr. 64 Prot.

Durrës, më 11.09.2024

Lënda: Njoftim për levizje paralele.

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Rruga "Bulevardi Bajram Curri", Tiranë

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit", të ligjit nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit".

Shkolla e mesme teknologjike "Hysen Çela" ju njofton krijimin e vendit të lire me orë per pozicionin

- Pozicioni: 1.Mësues me 10 orë i praktikës profesionale, drejtimi (Detari).

1 Mësues me 10 orë i praktikës profesionale, drejtimi (Tekstil-Konfeksione)

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- Kritere të përgjithshme:** a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën; c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale; d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk

janë shuar; e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit; f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2. Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

2.Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të praktikës profesionale ne ofruesin e AFP-së që ofrojnë arsim profesional .

a)Te ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me kualifikimin /kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së ,për të cilin /cilat po aplikon .b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet; c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

3. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njohimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:a - letërmotivimin për pozicionin; b- jetëshkrimin (CV-në); c- kartën e identitetit; d- diplomën; e- librezën e punës; f- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV; g- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit; h- vërtetimin e gjendjes shëndetësore; i- vërtetimin e gjendjes gjyqësore; j- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;k - të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e Shkolles së Mesme Teknologjike "Hysen Çela", brenda datës ... 24.09. 2024

Shënim : Për levizje paralele nuk u paraqit asnjë dosje.

DREJTORE

Dr. Blerina DERVISHI

